



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 135, datë 29.10.2020

PËR

**MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS
SË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME DETARE**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme Detare të jetë sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Drejtorisë së Përgjithshme Detare të jetë sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Numri i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Detare të jetë, gjithsej, 70 veta.
4. Urdhri nr.73, datë 21.4.2016, i Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme Detare", i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDIRAMA